



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**Legjislatura VIII**  
**Sesioni pranveror**

---

Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë  
Mbledhja nr. 79  
Prishtinë, më 2.4.2024, në orën 18:15  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**Procesverbal**

**Në mbledhje morën pjesë:** Fitore Pacolli-Dalipi, Adelina Grainca, Yllza Hoti, Gazmend Gjyshinca, Ariana Musliu-Shoshi dhe Doarsa Kica-Xhelili.

**Munguan:** Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, Xhavit Haliti, Time Kadrijaj dhe Bahrim Sabani.

**Të pranishëm në takim:** z. Bertrand Bouyx, kryetar i Komisionit për Çështje Politike dhe Demokraci në Asambenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, z. Olivier Guérot, Amabasador i Republikës së Francës në Kosovë, z. Mohamed Sadoun dhe z. Xavier Rouard.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Adriana Qenaj - Osmani, asistente e deputetes.

**Nga Zyra e Komisionit:** Manush Krasniqi.

Takimin e kryesoi deputetja Fitore Pacolli-Dalipi, sipas autorizimit në mungesë të kryetares dhe nënkryetarit të komisionit.

**Rendi i ditës:**

Takim me z. Bertrand Bouyx, Kryetar i Komisionit për Çështje Politike dhe Demokraci në Asambenë Parlamentare të Këshillit të Evropës.

**Fitore Pacolli-Dalipi**, i uroi mirëseardhje z. Bouyx, dhe e falënderoi atë për angazhimin dhe ndihmën e tij për Kosovën në Asambenë Parlamentare të Këshillit të Evropës. Kosova, tha se ka bërë hapa shumë pozitiv sa i përket fuqizimit të demokracisë, të drejtave të njeriut, të drejtave dhe lirive fetare dhe mbrojtjen e minoriteteve, po ashtu edhe në luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar. Kosova prinë në raportet ndërkombëtare sa i përket këtyre fushave, dhe së fundi në raportin e Varieties of Democracy, është theksuar se Kosova po vazhdon të demokratizohet. Kjo, tha se tregon shumë për Kosovën dhe angazhimin e saj për thellimin e demokracisë, për respektimin e të drejtave civile dhe respektimin e minoriteteve në Kosovë. Anëtarësimi i Kosovës në KE, është jashtëzakonisht i rëndësishëm për të gjithë qytetarët e Kosovës, sidomos për minoritetet dhe grupet e marginalizuara, sepse u jep një mundësi që

ata t'i adresohen Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kur atyre ju cenohen të drejtat. Si forcë politike, tha se e kanë për synim që Kosovën ta shpjen përpara dhe të tregojnë se në rajon është e mundur që të ketë zhvillime pozitive, është i mundur demokratizimi dhe është i mundur përqaftimi i vlerave të BE-së. Ajo kërkoi që anëtarësimi i Kosovës në KE të mos lidhet me ecjen e dialogut Kosovë-Serbi, pasi që kjo vetëm e ngadalëson ecjen e Kosovës drejtë demokratizimit, fuqizimit dhe mbrojtjes të së drejtave të njeriut. Ngadalësimi i Kosovës drejtë KE-së, tha se jep sinjal jo të mirë, sidomos për shtetet që janë duke ecur rrugës jo të duhur, jodemokratike, por drejt autoritarizmit.

**Bertrand Bouyx**, tha se është i lumtur që është në Kosovë në një situatë të veçantë pas votimit pozitiv të raportit për aplikimin e Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës nga Komisioni për Çështje Politike dhe Demokraci. Procesi i anëtarësimit të Kosovës në KE është një proces me etapa. Etapa e parë ka qenë votimi në komision, etapa e dytë do të zhvillohet në prill, ku anëtarësimi i Kosovës do të votohet nga e gjithë Asambleja e KE-së dhe pastaj vendimi përfundimtar do të merret nga Komiteti i Ministrave. Raporti i raportueses për Kosovën, znj. Bakoyannis, tha se i ka përmendur tri pika kryesore. Pika e parë ka qenë një kusht i rëndësishëm që kishte të bënte me Manastirin e Deçanit. Kjo çështje tashmë është zgjidhur dhe është pranuar letra nga Kryeministri Kurti lidhur me këtë. Pika e dytë, tha se ka të bëjë me Asociacionin e komunave serbe. Për këtë tha se ka dëgjuar nga përfaqësuesit e Kosovës se kjo çështje nuk duhet të lidhet me anëtarësimin e Kosovës në KE, por pret nga Qeveria që për këtë çështje të kërkojë mendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Çështja e tretë e përmendur në raport është çështja e shpronësimeve. Kjo është një temë që ka të bëjë me të drejtën e brendshme të vendit, por meriton që në kuadër të zhvillimit të procesit politik të merret parasysh. Këto, tha se janë pikëpamjet e tij si kryetar i Komisionit për Çështje Politike dhe Demokraci dhe se në një moment të caktuar do të ngritën edhe tek Komiteti i Ministrave.

Sa i përket dialogut me Serbinë, tha se avancimi i raporteve në dialog do të avanconte më tej në klasifikimin më të lartë, sepse në rrugën drejt asaj që presin që gjitha vendet demokratike, respektimi i Gjykatës Kushtetuese, është ajo që bënë të respektohet korniza ligjore kushtetuese.

**Fitore Pacolli-Dalipi**, tha se sa i përket çështjes së Manastirit të Deçanit, Kosova e ka respektuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese, që ka qenë një hap shumë i rëndësishëm për Kosovën dhe të ardhmen e saj. Sa i përket dy çështjeve tjera, që i ka ngritur në raportin e saj znj. Bakoyannis, tha se janë çështje që Kosova ka treguar që është e interesuar të punojë në këtë proces, sidomos në procesin e dialogut me Serbinë. Ajo shtoi se, Kosova është duke dialoguar me një shtet jo të lehtë, me Serbinë e cila nuk është bashkëpunuese në raport me arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse, përmes së cilës do të njihnin njëra-tjetrën, do ta pranonin njëra-tjetrën si të dy shtete, do të respektonin vendimet dhe arritjet e marrëveshjes. Serbia deklaroi se nuk është e gatshme për këtë dhe kërcënon vazhdimisht. Përkundër të gjitha këtyre kërcënimeve, Kosova është duke u munduar që të ketë përafrim në dialog dhe është aktive me propozimin e rrugëdaljeve. Ngadalësimi në arritjen e një marrëveshjeje në mes të Kosovës dhe Serbisë, tha se i dëmton qytetarët e Republikës së Kosovës, në të njëjtën kohë edhe qytetarët e Republikës së Serbisë, sepse Kosova dhe Serbia janë shtete fqinje, të cilat duhet ta arrijnë një marrëveshje dhe të ecin tutje. Një frymë e tillë, tha se nuk po shihet në Serbi, e cila në raporte të shumta është duke u konsideruar si autokraci elektorale, që e vështirëson rrugën drejt zgjidhjes së problemit me Serbinë. Pacolli kërkoi që Kosova të vlerësohet për punën që është duke e bërë, kjo do të ishte shumë reale, sepse është duke e bërë maksimumin që të arrijë marrëveshje, që të dilet nga kjo situatë, mirëpo, kjo nuk varet vetëm nga Kosova.

**Ariana Musliu-Shoshi**, e falënderoi z. Bouyx për mbështetjen e tij dhe të delegacionit francez në Këshillin e Evropës. Ajo, e falënderoi edhe Francën për ndihmën që ka dhënë, jo vetëm tani në këtë legjislaturë në AP-KE, por që nga dita e parë kur Kosova është pjesëmarrëse. Ajo shtoi se është në dijeni

që nuk ka qenë e lehtë të mbrohet Republika e Kosovës në këtë institucion, por z. Bouyx dhe delegacioni i tij gjithmonë ia kanë dalë dhe kanë qenë në krahun e Kosovës.

**Doarsa Kica-Xhelili**, e falënderoi z. Bouyx për kohën e tij dhe pret që gjatë vizitave tjera të tij të vizitojë edhe zyrat e LDK-së dhe të bashkëbisedojnë, pasi që ka çështje që në raport me të cilat nuk i kanë qëndrimet, leximet apo interpretimet e njëjta të situatave të ndryshme.

**Bertrand Bouyx**, sa i përket çështjet se dialogut, tha se është e rëndësishme që përtej dialogut të shihet tërësia e Kosovës si shtet sovran dhe në këtë sovranitet të keni besim në institucionet që i ka Kosova. Në këtë drejtim, tha se në raportin e znj. Bakoyannis janë ngritur disa çështje, por në fund llogaritet ajo se çfarë thotë Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Shumica e deputetëve dhe shteteve anëtare mendojnë se duhet të dëgjohet mendimi i Gjykatës Kushtetuese, lidhur me Asociacionin e komunave serbe. Kjo edhe pse nuk është kusht për anëtarësimin e Kosovës në KE, por në një moment të caktuar do të ngritet kjo çështje, sepse është çështje e besimit në një shtet sovran.

**Fitore Pacolli-Dalipi**, tha se deputetët e Kosovës marrin kërkesa edhe nga shqiptarët që jetojnë përreth kufirit me Kosovën, nga banoret e komunave të Bujanocit, Preshevës dhe Medvegjës, të cilëve Serbia është duke ia shkelur të drejtën elementare për të pasur të drejtën e shtetësisë. Këtë diskriminim Serbia e ka filluar kohë më parë me komunën e Medvegjës, ku një numri të madh të shqiptarëve ua ka marrë shtetësinë. Me të njëjtën fushatë intensive është duke vazhduar edhe në qytetin e Bujanocit, ku një numri të madh të banorëve shqiptarë, Serbia është duke ua hequr shtetësinë. Kërkoj që kjo çështje të adresohet në Komisionin për Çështje Politike dhe Demokraci si dhe në Asamblenë Parlamentare të KE-së, si një çështje që i shqetëson qytetarët shqiptarë që jetojnë në Serbi, sepse interesat dhe shqetësimet e tyre nuk janë duke u adresuar nga shteti serb.

**Bertrand Bouyx**, sa i përket kësaj çështjeje, tha se mjafton që Shqipëria të bëjë kërkesë, meqë është anëtare e KE-së dhe ta ngris këtë çështje. Bouyx, njoftoi se në kuadër të KE-së ka mjete juridike përmes së cilëve ata mund ta bëjnë një rezolutë, duke kërkuar një raport lidhur me heqjen e shtetësisë ose diskriminimin e shqiptarëve në Serbi. Mundësia e dytë, është procesi i monitorimit, Serbia monitorohet rregullisht dhe në kuadër të monitorimit dhe raportet që bëhen të ngritet kjo çështje. Po ashtu, edhe pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, qytetarët mund të ankohen për të drejtat e tyre që janë shkelur.

Mbledhja përfundoi në orën 19:00.

E përgatiti:  
Stafi mbështetës i Komisionit.

Fitore Pacolli-Dalipi

---

Anëtare e Komisionit